

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mire Beqiraj, në çështjen penale kundër të akuzuarit : A. ... H. ... N. ... nga Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 parag.1, të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr. 1115-4/17, të datës, 25.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në prezencën e Prokurorit të Shtetit në Prizren Elfete Purova, të akuzuarit A. ... H. ... N. ... me datë 02.05.2017, morri dhe në prezencën e palës publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM**I akuzuari:**

A. ... H. ... N. ... nga i ati H. ... e ëma H. ... me mbiemër vajëzire G. ... i lindur me datë ... në Tropoj, tani me banim në Tiran, ... ku edhe banon, me nr. të tel. +383 ... ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, punëtor, i divorcuar, Shqipëtarë, Shtetas i Republikës së Shqipërisë.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 24.04.2017, rreth orës 20.40 min., në Prizren, në rrugën „De Rada“, pikërisht afër stacionit të autobusëve, me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit B. ... në atë mënyrë që e ndalon të dëmtuarin dhe kërkon nga ai që t'ia blej 2(dy) Qofte, i dëmtuari i tregon që nuk ka para, nëse nuk beson i thot: „ më kontrollo“, dhe në atë moment i pandehuri prap i thot: „ qiti paret“, dhe e grushton në fytyrë, por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore.

Kësodore ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 parag.1, të KP-së

Andaj gjykata në kuptim të nenit 6, 11, 15 31, 32, 33, 34, 36, 41, 42, 43, 44, 64, nenit 154 parag. 1 nënparag. 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i'a shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit A. ... H. ... N. ... ia vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Konform nenit 71 paraga. 1 të KP-së, të akuzuarit i shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që i akuzuari A. ... H. ... N. ... dëbohet nga territori i Republikës së Kosovës dhe të njëjtit i ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike materjale, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen materjale të akuzuarit.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren –Departamenti i përgjithëshem , kësaj gjykate I ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr. 1115-4/17, të datës 25.04.2017, kundër të akuzuarit : A. H. N. nga Republika e Shqipëris, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 parag.1, të KP-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar gjendjen faktike.

Se me datën 24.04.2017, rreth orës 20.40 min., në Prizren, në rrugën „De Rada’, pikërishtë afër stacionit të autobusëve, me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit B. S. në atë mënyrë që e ndalon të dëmtuarin dhe kërkon nga ai që t’ia blej 2(dy) Qofte, i dëmtuari i tregon që nuk ka para, nëse nuk beson i thot: „ më kontrollo”, dhe në atë moment i pandehuri prap i thot: „ qiti paret”, dhe e grushton në fytyrë, por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore.

Gjykata gjendjen e këtill faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësis nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajin përshkak të cilit Gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare Gjykata, konform nenit 257, të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tersi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë, e që pranimi i fajit është bërë në mënyr vullentare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materjale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materjale. Gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248, të KPP-së , dhe faktet që përmban aktakuza, ashtu që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 187 parag.1, të KP-së, dhe për këtë Gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënim me kusht, dhe plotësues , paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësin e tij penale juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kushtet e dispozitave të nenit 73, të KP-së, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, duke mos gjetur rrethana renduese e që si rrethan lehtësuese është marrë pranimi i fajësis nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, vepra është kryer nga pakujdesia, pasi që gjendja e till ekonomike materjale i’a ka imponuar një veprim të tillë, andaj Gjykata i shqiptoj dënimin me kusht , sepse konsideron se me kercenim të dënimin të tillë do të arrihet qëllimi i dënimin, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (viti), nuk kryen vepër tjetër penale, dhe dënimin plotësues dëbimi i të huajve nga territori i Republike së Kosovës dhe ndalesa që të mos hynë në Kosovë, në periudhën prej 1(një) viti, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkalles së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin që në të ardhmen të jetë më i kujdesëshem dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor , Gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta liroj nga shpenzimet dhe paushalli gjyqësor në kushtet e nenit 453, parag.4, të KPP-së, dhe atë duke u bazuar në deklaratën e të akuzuarit se i njëjti është puntor, është mbajtës i familjes, me këto dëshmon se është i gjendjes së rëndë ekonomike, pagesa e shpenzimeve të procedurës do të rrezikonte gjendjen materjale të tij, ose të personave që ai detyrohet ti mbështes materjalishtë.


Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.856/17, të datës 02.05.2017

**Sekretare Juridike
Mire Beqiraj**

**Gjyqtari
Gani Kastrati**



UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

- 1 - Udhëzime
- 1 - 4 - Aktgjykimet
në përmbajtje
- 4 - Aktgjykimet